



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 200

Tiranë – E hënë, 23 nëntor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 118/2015 datë 29.10.2015	Për një shtesë në ligjin nr. 74/2015, “Për miratimin e marrëveshjeve ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “S2 Albania”, sh.p.k. dhe “Rapiscan systems”, INC, “Për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve” dhe “Për ndryshimin e marrëveshjes së koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 123/2013”, si dhe të tarifës së shërbimit të skanimit” 13169
Ligj nr. 119/2015 datë 6.11.2015	Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile..... 13170
Ligj nr. 120/2015 datë 6.11.2015	Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit për vitin 2014..... 13174
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 134, datë 11.11.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 131, datë 31.10.2015 “Për miratimin e rregullave të ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Evropën Juglindore (SEE CAO)”, versioni 1.2 13174
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 135, 13.11.2015	Për miratimin e rregullave të ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Evropën Juglindore (SEE CAO), versioni 1.3 13175



LIGJ
Nr. 118/2015

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 74/2015, “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJEVE NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE SHOQËRIVE “S2 ALBANIA”, SHPK DHE “RAPISCAN SYSTEMS”, INC, “PËR ZGJIDHJEN ME MIRËKUPTIM TË MOSMARRËVESHJEVE” DHE “PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT PËR FINANCIMIN, NGRITJEN DHE OPERIMIN E SHËRBIMIT TË SKANIMIT TË KONTEJNERËVE E AUTOMJETEVE TË TJERA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, MIRATUAR ME LIGJIN NR. 123/2013”, SI DHE TË TARIFËS SË SHËRBIMIT TË SKANIMIT”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 74/2015, “Për miratimin e marrëveshjeve ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “S2 Albania”, sh.p.k. dhe “Rapiscan systems”, INC, “Për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve” dhe “Për ndryshimin e marrëveshjes së koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 123/2013”, si dhe të tarifës së shërbimit të skanimit”, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 2, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Përjashtohen nga pagesat e tarifës së shërbimit të skanimit, të përcaktuara në pikat 1 e 2, të këtij neni, deklaratat doganore për:

a) mallrat e vendosura në regjimin e transitit, kur ky regjim përfundon në një zyrë doganore shqiptare për të marrë një destinacion tjetër doganor;

b) mallrat që dalin nga regjimi i magazinimit doganor drejt një destinacioni tjetër doganor, me përjashtim të rieksportit;

c) mallrat që hyjnë në magazinat e lira dhe, gjithashtu, mallrat që dalin nga magazinat e lira me procedurë rieksporti;

ç) asgjësimin e mallrave nën kontroll doganor; shkatërrimin e mallrave pas regjimit të përpunimit aktiv me rimbursim; shkatërrimin e mallrave që kanë qenë nën regjimin e përpunimit aktiv me pezullim; shkatërrimin e mallrave pas regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë; shkatërrimin e mallrave pas regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm; shkatërrimin e mallrave që kanë qenë në magazinim doganor; sistemim situatë, pas hyrjes së mallrave në magazinë të lirë; diferencën në matje; diferencën në matje në magazinë të lirë; frot natyrore pas regjimit të përpunimit aktiv me rimbursim; frot natyrore ose teknike të mallrave që kanë qenë në regjimin e përpunimit aktiv me pezullim; frot natyrore ose teknike të mallrave që kanë qenë në magazinim doganor; frot natyrore ose teknike të mallrave që kanë qenë në magazinë të lirë;

d) mallrat që vendosen në qarkullim të lirë, pas vendosjes në regjimet doganore pezulluese;

dh) mallrat e importuara nën regjimin e përpunimit aktiv dhe produkteve kompensuese të dala prej tij (rieksport dhe destinacione të tjera, përveç hedhjes në qarkullim të lirë);

e) transferimet nga një regjim pezullues/ekonomik në tjetrin;

ë) importet rastësore të mallrave me natyrë jotregtare (deklarata të thjeshtuara).”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 29.10.2015

Shpallur me dekretin nr. 9319, datë 18.11.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani



LIGJ
Nr. 119/2015

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E KËSHILLIT KOMBËTAR PËR
SHOQËRINË CIVILE

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Krijimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, për të garantuar bashkëpunimin institucional me organizatat e shoqërisë civile në Republikën e Shqipërisë, në dobi të zgjerimit të demokracisë, konsolidimit të qeverisjes së mirë dhe rritjes së transparencës në vendimmarrjen publike, nëpërmjet përfshirjes më të mirë të shoqërisë civile në këtë proces.

2. Zhvillimin e bashkëpunimit institucional me organizatat e shoqërisë civile, për hartimin e zbatimin e strategjisë kombëtare dhe udhërrëfyesit të Qeverisë Shqiptare, për krijimin e një kuadri mundësues për sektorin e shoqërisë civile dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërsektorial mes institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe për zhvillimin e filantropisë dhe kapitalit social.

3. Përcaktimin e parimeve dhe procedurave, në bazë të të cilave drejtohet dhe zhvillohet procesi i dialogut dhe i këshillimit në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “KKSHC” është Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile.

2. “AMSHC” është Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, ent publik qendror buxhetor, që organizohet e funksionon sipas legjislationit në fuqi.

3. “OSHC” janë organizata të shoqërisë civile, të cilat mund të jenë organizata jofitimprurëse ose entitete të tjera të shoqërisë civile, që nuk janë regjistruar si OJF, por që ushtrojnë veprimtari në të mirë dhe interes të publikut.

Neni 3
Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është organizimi dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të tij.

Neni 4
Parimet në të cilat mbështetet procesi i
dialogut dhe i këshillimit

Procesi i dialogut dhe këshillimit në KKSHC bazohet në:

a) parimin e këshillimit, nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, komenteve, vërejtjeve e sugjerimeve me OSHC-të për rekomandimet që propozohen nga KKSHC-ja;

b) parimin e transparencës, nëpërmjet publikimit, në faqet zyrtare të internetit të AMSHC-së dhe Këshillit të Ministrave, të rekomandimeve të nxjerra nga KKSHC-ja gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, si dhe njoftimit dhe vënies në dispozicion të OSHC-ve të rekomandimeve që propozohen nga KKSHC-ja;

c) parimin e konsultimit me grupe të interesit, nëpërmjet përfshirjes së grupeve të ndryshme të interesit në procesin e këshillimit dhe dialogut të KKSHC-së.

Neni 5
Statusi dhe personaliteti juridik

1. KKSHC-ja është organ kolegjial këshillimor, autonom, pranë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

2. KKSHC-ja vepron për përmbushjen e qëllimeve të këtij ligji, parashikuar, shprehimisht, në nenin 1 të tij.

3. KKSHC-ja organizohet dhe funksionon në bazë të këtij ligji dhe rregullores së vet të organizimit dhe funksionimit.

4. Rregullorja përcakton rregulla të detajuara për thirrjen, njoftimin dhe organizimin e mbledhjes së KKSHC-së, si dhe rregulla të tjera të nevojshme të organizimit dhe funksionimit.



Rregullorja miratohet, në mbledhjen e parë të KKSHC-së, me votat e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve. E njëjta shumicë kërkohet edhe për ndryshimet e rregullores.

5. KKSHC-ja mblidhet, të paktën, 3 herë në vit, si dhe kur kërkohet nga 1/3 e anëtarëve të saj.

6. Mbledhjet e KKSHC-së mbahen në mjediset e ndërtesës së Kryeministrisë.

7. Në ushtrimin e funksioneve të saj, KKSHC-ja mbështetet nga AMSHC-ja, e cila kryen funksione ndihmëse dhe administrative për KKSHC-në, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 6 Përbërja e KKSHC-së

1. KKSHC-ja përbëhet nga 27 anëtarë, nga të cilët 13 përfaqësues të institucioneve publike, 13 përfaqësues të OJF-ve dhe 1 përfaqësues nga komuniteti i biznesit, anëtar i Këshillit Ekonomik Kombëtar.

2. Mandati i përfaqësuesve të institucioneve publike dhe përfaqësuesit të Këshillit Ekonomik Kombëtar në KKSHC është i lidhur me afatin, gjatë të cilit ata ushtrojnë detyrën përkatëse publike, për shkak të së cilës caktohen dhe anëtarë të KKSHC-së.

3. Përfaqësuesit e institucioneve publike në KKSHC janë, përkatësisht:

a) Kryeministria	1 anëtar;
b) Ministria e Drejtësisë	1 anëtar;
c) Ministria e Punëve të Brendshme	1 anëtar;
ç) Ministria e Integritimit Evropian	1 anëtar;
d) Ministria e Financave	1 anëtar;
dh) Ministria e Mjedisit	1 anëtar;
e) Ministria e Shëndetësisë	1 anëtar;
ë) Ministria e Arsimit dhe Sportit	1 anëtar;
f) Ministria e Kulturës	1 anëtar
g) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	1 anëtar;
gj) Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	1 anëtar;
h) Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin	1 anëtar;
i) Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile	1 anëtar.

4. Përfaqësuesit e institucioneve publike në KKSHC, që përmenden në pikën 3, të këtij neni, do të jenë në nivel zëvendësministrash ose në

nivele të tjera të larta drejtuesish.

5. Institucioni publik cakton përfaqësuesin e tij në KKSHC, si dhe zëvendësin përkatës, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe i dërgon, menjëherë, të dhënat e identitetit në AMSHC. E njëjta procedurë zbatohet edhe në rast zëvendësimi të përfaqësuesit ose zëvendësit të tij.

6. OJF-të zgjedhin si anëtarë të tyre në KKSHC katër përfaqësues të shoqërisë civile për secilin nga sektorët e mëposhtëm:

a) demokratizimi, shteti i së drejtës, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE;

b) zhvillimi ekonomik, territorial dhe mjedisor;

c) mirëqenia, shërbimet sociale, mbrojtja e shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës.

7. Procesi i propozimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të KKSHC-së nga radhët e OJF-ve kryhet sipas procedurave, kushteve dhe afateve që parashikohen, shprehimisht, në rregulloren e KKSHC-së. Rregullat për zgjedhjen e anëtarëve të parë të KKSHC-së që përfaqësojnë OJF-të parashikohen në nenin 16 të këtij ligji.

Neni 7 Funksionimi i KKSHC-së dhe marrëdhëniet institucionale

1. Mbledhjet e KKSHC-së janë të vlefshme kur në to merr pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të saj. Vendimet e KKSHC-së merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, përveç rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj.

2. Çdo institucion publik duhet të vërë në dispozicion të KKSHC-së informacionin e kërkuar për financimin e projekteve dhe programeve të OJF-ve dhe OSHC-ve, si dhe çdo informacion që lidhet me mbështetjen e shoqërisë civile.

3. KSHC-ja miraton raportin vjetor për veprimtarinë e saj jo më vonë se data 30 janar e vitit pasardhës.

4. Këshilli raporton mbi veprimtarinë e tij, të paktën, një herë në vit, pranë Këshillit të Ministrave, ose sa herë që i kërkohet nga ky i fundit.



Neni 8

Detyrat e KKSHC-së

Detyrat e KKSHC-së janë:

1. Këshillon Këshillin e Ministrave për përcaktimin e politikave shtetërore për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile.

2. I propozon Këshillit të Ministrave programet kryesore për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe përfshirjen e këtij sektori në problematika që lidhen me kryerjen e reformave në fushën ekonomike, sociale, integrimin evropian, respektimin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në vend.

3. Këshillon Këshillin e Ministrave për përmirësime legjislative që ndikojnë zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri dhe përfshirjen e tyre në vendimarrjen publike.

4. Jep rekomandime për politikat publike që lidhen apo ndikojnë në veprimtarinë dhe zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile, si dhe përfshirjen e tyre në bashkëpunimin ndërsektorial.

5. Jep mendime, për Këshillin e Ministrave dhe AMSHC-në, për planifikimin e prioritetëve lidhur me shpërndarjen e fondeve publike, në mbështetje të programeve e projekteve të organizatave të shoqërisë civile, si dhe për analizën e raporteve vjetore të ministrive dhe agjencive të tjera qeveritare për projektet dhe programet e financuara.

6. I jep mendime Këshillit të Ministrave për përcaktimin e prioritetëve, në lidhje me fondet e Bashkimit Evropian apo institucioneve të tjera ndërkombëtare për Shqipërinë, që ndikojnë zhvillimin e shoqërisë civile.

Neni 9

Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të KKSHC-së, përfaqësues të OJF-ve

1. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të KKSHC-së, përfaqësues të OJF-ve, përveç anëtarëve të parë, që zgjidhen sipas procedurës së parashikuar në nenin 16, të këtij ligji, është tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje një herë, përfshirë edhe përfaqësuesin e Këshillit Ekonomik Kombëtar. Kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së përfaqësuesve të OJF-ve në KKSHC përcaktohen në rregulloren e KKSHC-së. Në

çdo rast, nuk mund të bëhet ripërtëritja e të gjithë anëtarëve të këshillit në të njëjtën kohë.

2. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit të KKSHC-së mbaron përpara afatit, në rastet kur:

a) jep dorëheqjen;

b) krijohen kushte të papajtueshmërisë apo të konfliktit të interesit, sipas dispozitave ligjore në fuqi;

c) humbet zotësinë juridike për të vepruar, me vendim gjykatë;

ç) nuk merr pjesë në, të paktën, tre mbledhje të KKSHC-së, të organizuara gjatë një viti;

d) dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;

dh) vdes.

3. Emërimi i anëtarit të ri bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në rregulloren e KKSHC-së, jo më vonë se 30 ditë nga data e mbarimit të mandatit të anëtarit që zëvendësohet. Anëtari i ri qëndron në detyrë për një mandat trevjeçar.

Neni 10

E drejta e votës dhe parandalimi i konfliktit të interesave

1. Të gjithë anëtarët e KKSHC-së kanë të drejtë vote të barabartë.

2. Anëtari i KKSHC-së nuk merr pjesë në diskutim dhe votim kur ai është në kushtet e konfliktit të interesit, parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 11

Shpërblimi i anëtarëve të KKSHC-së

Anëtarët e KKSHC-së nuk marrin shpërblim për kontributin e tyre në KKSHC. Shpenzimet e bëra në kuadër të veprimtarisë së KKSHC-së mbulohen nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Neni 12

Publikimi i rekomandimeve të KKSHC-së dhe format e komunikimit

1. Çdo rekomandim apo qëndrim i KKSHC-së në ushtrim të funksioneve të saj përbën informacion me interes publik, në përputhje me kuadrin ligjor për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare.



2. Emrat e anëtarëve të KKSHC-së, rregullorja e saj, raportet e paraqitura në Këshillin e Ministrave, çdo rekomandim, plan veprimi, si dhe mendimet apo qëndrimet për aktet që ajo shqyrton, afishohen në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Ministrave dhe të AMSHC-së, me qëllim informimin e publikut.

Neni 13

Organet e KKSHC-së

1. Organet e KKSHC-së janë:

- a) Kryetari;
- b) Zëvendëskryetari;
- c) AMSHC-ja, që luan rolin e sekretariatit teknik të KKSHC-së.

2. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të organeve të KKSHC-së përcaktohet në rregulloren e KKSHC-së. Në kryerjen e detyrave dhe në përmbushjen e qëllimeve të saj, KKSHC-ja mund të krijojë grupe pune të përkohshme, me ekspertë, në ndihmë të përcaktimit të qëndrimit përkatës, lidhur me çështje të caktuara.

3. Organet e KKSHC-së i kryejnë funksionet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, legjislacionit në fuqi, rregulloren e KKSHC-së dhe akte të tjera të miratuara prej saj.

Neni 14

Kryetari dhe Zëvendëskryetari i KKSHC-së

1. Kryetari i KKSHC-së është Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Kryetari i KKSHC-së kryen këto detyra:

- a) përfaqëson KKSHC-në në marrëdhëniet me palë të treta;
- b) thërret mbledhjet e KKSHC-së dhe organizon rendin e ditës, në konsultim me anëtarët e tjerë të saj dhe me AMSHC-në, në përputhje me rregulloren e KKSHC-së;
- c) drejton mbledhjet e KKSHC-së;
- ç) siguron bashkëpunimin me institucionet publike dhe personat juridikë, vendas ose të huaj, për mbarëvajtjen e veprimtarisë së KKSHC-së;
- d) në rast të mungesës së tij, detyrat e Kryetarit ushtrohen nga Zëvendëskryetari.

2. Zëvendëskryetari i KKSHC-së zgjidhet nga radhët e anëtarësisë së KKSHC-së, përfaqësues i organizatave jofitimprurëse. Zëvendëskryetari emërohet dhe shkarkohet me votën e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të KKSHC-së, me një mandat trevjeçar.

3. Zëvendëskryetari që zgjidhet nga KKSHC-ja sipas parashikimeve të këtij neni, mandati i të cilit, në kuptim të parashikimeve pikës 4, të nenit 16, të këtij ligji, është më i vogël se tre vjet, do të ketë, automatikisht, një mandat trevjeçar, nga dita e emërimit si anëtar i KKSHC-së.

Neni 15

Sekretariati teknik i KKSHC-së

1. AMSHC-ja luan rolin e sekretariatit teknik të KKSHC-së dhe lehtëson, nga ana logjistike, mbajtjen e takimeve. AMSHC-ja kryen vetëm funksione ndihmëse dhe administrative për KKSHC-në.

2. Shpenzimet, në lidhje me veprimtarinë e KKSHC-së, mbulohen nga AMSHC-ja, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 16

Dispozita kalimtare

1. Zgjedhja e përfaqësuesve të parë të OJF-ve në KKSHC bëhet nëpërmjet një procedure publike e transparente njoftimi e propozimi dhe në bazë të zgjedhjeve të hapura, që organizohen nga vetë OJF-të, sipas kriterëve dhe procedurave të vendosura prej tyre. AMSHC-ja lehtëson punën e OJF-ve në zhvillimin e këtij procesi, duke ofruar mbështetje teknike në organizimin e procedurave dhe publikimin e rezultateve.

2. Procesit i përzgjedhjes së përfaqësuesve të OJF-ve në KKSHC është i hapur për të gjitha OJF-të e regjistruara rregullisht dhe që gëzojnë status aktiv pranë organeve tatimore në të gjithë vendin. AMSHC-ja publikon kriteret që duhet të plotësojnë OJF-të për të paraqitur kandidaturat për anëtarë të KKSHC-së, mënyrën e votimit, administrimin e procesit dhe shpalljen e rezultateve.

3. Rregullat e detajuara për procesin e përzgjedhjes, siç parashikohet në këtë nen, duhet të përcaktohen brenda 20 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Procedurat e përzgjedhjes së përfaqësuesve të OJF-ve në KKSHC duhet të zhvillohen jo më vonë se 45 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

4. Pas shpalljes së kandidatëve fitues, AMSHC-ja organizon një short për të përcaktuar kohëzgjatjen e mandatit të secilit anëtar të KKSHC-së, duke u bazuar në rregullin që 4 anëtarë do kenë mandat njëvjeçar, 4 anëtarë do të



kenë mandat dyvjeçar dhe 5 anëtarë do të kenë mandat trevjeçar.

5. Shpenzimet për procesin e përzgjedhjes së përfaqësuesve të OJF-ve në KKSHC mbuloohen nga fondet e AMSHC-së si dhe nëpërmjet dhurimeve e burimeve të tjera të ligjshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miruar në datën 6.11.2015

Shpallur me dekretin nr. 9317, datë 16.11.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 120/2015

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË SHETIT PËR VITIN 2014

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 158 të Kushtetutës, dhe të nenit 63, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratimi i buxhetit faktik

Miratohet Buxheti faktik i Shtetit për vitin 2014 së bashku me burimet e tij të financimit, si më poshtë:

	Në milionë lekë
1. Buxheti i Shtetit	
- Të ardhurat gjithsej	282 733
- Shpenzimet gjithsej	360 273
2. Buxheti vendor	
- Të ardhurat gjithsej	32 665
- Shpenzimet gjithsej	32 995
3. Buxheti i ISSH-së	
Të ardhurat	109 435

Faqe | 13174

Shpenzimet	102 794
4. Buxheti i FSDKSH-së	
Të ardhurat	32 328
Shpenzimet	32 225
5. Buxheti i AKKP-së	
- Të ardhurat gjithsej	315
- Shpenzimet gjithsej	1 317
6. Deficiti buxhetor	-72 128
7. Financimi i deficitit buxhetor	72 128
I brendshëm	42 237
A. Me instrumente financiare (kredimarrje e brendshme neto)	38 212
1. Kredimarrje nga pushteti qendror	37 750
- Bono thesari	14 821
- Obligacione qeveritare 2/3/5/7/10-vjeçare	22 929
2. Kredimarrje nga pushteti vendor	462
B. Të ardhura nga privatizimi	35
C. Të tjera	3 990
- Ndryshimi i gjendjes së arkës	-389
- Të tjera	4 379
Financimi i jashtëm (neto)	29 891
Nga i cili: Mbështetje buxhetore	30 460

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miruar në datën 6.11.2015

Shpallur me dekretin nr. 9318, datë 16.11.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 134, datë 11.11.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 131, DATË 31.10.2015, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS SË KOORDINUAR TË ANKANDEVE PËR EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO)”, VERSIONI 1.2

Në bazë të neneve 16 dhe 18, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 112, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.2008, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 16, pika 3, të



Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 11.11.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST, sh.a. mbi vendimin nr. 131, datë 31.10.2015, të Bordit të ERE-s, “Për miratimin e rregullave të ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO)”, versioni 1.2, si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 131, datë 31.10.2015, “Për miratimin e rregullave të ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO)”, versioni 1.2, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 2 ndryshohet: “2. Efektet juridike të zbatimit të vendimit nr. 156, datë 1.12.2014, “Rregullat e ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO)”, janë ato të përcaktuara nga SEE CAO”;

b) Shtohet pika 4 me përmbajtje si më poshtë:

“Ankandet e kapaciteteve të interkonjeksionit për kufijtë, që janë të përjashtuara sipas procedurës së SEE CAO, për pjesën e mbetur të vitit 2015, OST, sh.a., duke filluar nga 31.10.2015, do t'i zhvillojë konform “Rregullores së alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit”, miratuar me vendimin nr. 140, datë 22.11.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST, sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 135, 13.11.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS SË KOORDINUAR TË ANKANDEVE PËR EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO), VERSIONI 1.3

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë

elektrike”, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2015, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur dhe të rënë dakord nga SEE CAO dhe TSO-të aksionarë të saj, të rregullave të ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO), versioni 1.3, dhe relacionin përkatës,

konstatoi se:

- Sekretari i Energjisë (Vjenë, Austri) dhe mbledhja e 11-të e ECBR-së, mbajtur në datën 9.7.2009, rekomandon që rregullatorët kombëtarë të miratojnë rregulloret e aprovuara nga SEE CAO.

- Rregullorja është e hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian.

- OST-ja, me shkresën nr. 5868/1 prot., datë 26.10.2015, ka kërkuar miratimin dhe hyrjen në fuqi të rregullave të ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO), versioni 1.3, brenda datës 17.11.2015.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë rregullat e ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore SEE CAO, versioni 1.3 (bashkëlidhur “Rregullat e ankandit, në gjuhën origjinale angleze”).

2. Drejtoria juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë personat e interesuar për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë